




Pjesë e Grupit RBl



# Manual për përdoruesit

[www.raiffeisen.al](http://www.raiffeisen.al)



## Përkufizimet dhe shkurtesat

Termi	Përshkrimi
Pajisje, telefon	Pajisja që përdoruesi përdor për RaiPay
NFC	Near Field Communication (Komunikim në zonë të afërt)
Kyçja e pajisjes, Ç'kyçja e pajisjes, Kyçja e telefonit, Ç'kyçja e telefonit (Device Lock, Device Unlock)	Zgjidhja e sigurisë që kontrollon qasjen e përdoruesit në pajisje (Kod, PIN, ID e gishtave, etj.)
FPAN	Numri i kartes siç tregohet në kartën plastike
Token	Numri i digjitalizuar i kartës
Portofoli (Wallet)	Portofoli digjital që mban të gjitha kartat e regjistruara
PIN	Numri Personal i Identifikimit
Fshij tokenin (Delete token)	Tokeni nuk mund të rifillohet dhe të përdoret përsëri
Fshij portofolin (Delete wallet)	Portofoli (përfshirë të gjithë kartat e regjistruara) nuk mund të rifillohet dhe të përdoret përsëri
Pezullo tokenin (Suspend token)	Tokeni pezullohet përkohësisht dhe mund të rifillohet
Pezullo portofolin (Suspend wallet)	Portofoli pezullohet përkohësisht dhe mund të rifillohet
Rifillo tokenin (Resume token)	Rifilloni tokenin pasi të jetë pezulluar më parë
Rifillo portofolin (Resume wallet)	Rifilloni portofolin pasi të jetë pezulluar më parë
SDK	Kompleti i zhvillimit të softuerit (Software Development Kit)
LVP	Pagesë me vlerë të ulët (vlerat aktuale të përcaktuara në dokument)
HVP	Pagesë me vlerë të lartë (vlerat aktuale të përcaktuara në dokument)
BVP	Pagesë me vlerë të madhe (vlerat aktuale të përcaktuara në dokument)
Limiti NAP	Limiti maksimal i pagesave të pa-autentikuara (pagesat që nuk kërkojnë ndonjë metodë autentikimi)
Shuma kumulative e NAP	Shuma e të gjitha pagesave të pa-autentikuara që nga fillimi rishtazi e shumës së fundit kumulative të NAP
Limiti i DUP	Limiti maksimal i pagesave me ç'kyçje të pajisjes (pagesat që kërkojnë zhblokimin e pajisjes)
Shuma kumulative e DUP	Shuma e të gjitha pagesave që kanë kërkuar ç'kyçjen e pajisjes që nga fillimi rishtazi e fundit e shumës kumulative të DUP


## Kërkesat

- Pajisja të ketë në dispozicion NFC dhe NFC të jetë e aktivizuar
- Pajisja të ketë versionin Android-it 7.0 apo më të ri
- Kyçja e pajisjes të jetë aktivizuar (RaiPay nuk do të funksionojë nëse përdoruesi nuk përdor ndonjë metodë të Kyçjes së Telefonit psh: Fjalëkalim, Gjurmë gishti, Profile të autorizuara për njohjen e fytyrës, etj.)
- Pajisja të mos jetë në modalitetin e zhvilluesve (developer mode)
- Pajisja të mos jetë bërë shkak-root ose të mos ketë të aktivizuar ndonjë formë tjetër që kompromenton sigurinë
- Qasja në internet është i nevojshëm gjatë regjistrimit të kartave (aksesi në internet nuk është i nevojshëm gjatë realizimit të pagesave)

# Pjesa 1:

---

# Shkarkimi dhe instalimi i RaiPay



## Shkarkimi i aplikacionit RaiPay

Për të përdorur aplikacionin RaiPay, duhet ta shkarkoni nga Google Play.

- ① Hapni Google Play Store dhe kërkoni RaiPay (Raiffeisen Bank Albania).
- ② Shkarkoni dhe instaloni RaiPay në pajisjen tuaj
- ③ Hapni aplikacionin RaiPay


**Tani jeni gati të filloni**



## Instalimi

Kur një përdorues hap RaiPay, shfaqet faqja e mirëseardhjes.


- ① Për të vazhduar, përdoruesit duhet të bien dakort me **Kushtet dhe Afatet** duke shënuar kutinë katrore. Shtypni **Kushtet dhe Afatet** për t'i shfaqur ato.
- ② Shtypni **Fillojmë!** për të vazhduar më tej.




- ③ Pajisja Android pyet nëse përdoruesi dëshiron të lejojë që RaiPay të kryejë dhe menaxhojë telefonata. RaiPay funksionon vetëm nëse kjo lejohet, përndryshe shfaqet një gabim (shiko hapin 5).

① **Informacion i dobishëm**

RaiPay dëshiron të krijojë lidhje me kartën SIM – për arsye sigurie (për shkak të teknologjisë HCE) dhe duhet të komunikojë me harduerin. Nuk kërkohet akses tek kontaktet ose tek kartaSIM




- ④ Përdoruesi duhet të lejojë që RaiPay të ketë qasje në fotografi, media dhe dosje në pajisje.



⑤

Shfaqet gabim kur përdoruesi nuk vendos ato që kërkohen. Butoni OK shfaq një dialog i njoftimeve me kërkesat përsëri.



⑥

Kontrolli i pajisjes dhe parakushtet për krijimin e portofolit.

- Versioni i sistemit operativ Android
- Shihni nëse telefoni nuk është në developer mode, i bërë root, etj.
- Google Safety Net – kontrolloni integritetin e pajisjes
- RaiPay krijon një gjurmë gishti unike të pajisjes


RaiPay do të mbyllet nëse kontrolli dështon



## Shtimi i një numri të telefonit

Përdoruesit duhet të shënojnë numrin e tyre të telefonit. Ky numër telefoni përdoret për identifikim unik në sistem kur përdoruesit kontaktojnë qendrën e kontaktit në lidhje me RaiPay.

Sidoqoftë, ky numër telefoni nuk përdoret më vonë për të aktivizuar një kartë për këtë qëllim, përdoret numri i telefonit të verifikuar përdoruesit në të dhënat bankare.



## Gabim në mbrojtjen e ekranit të mbyllur

Nëse mbrojtja e ekranit të mbyllur (lock screen protection) të pajisjes është e çaktivizuar, përdoruesit i shfaqet një gabim dhe duhet të aktivizojë mbrojtjen e ekranit të mbyllur të pajisjes.






## Krijimi i kodit të RaiPay

- ① Caktoni një Kod 4-shifror të aplikacionit RaiPay.



### Informacion i dobishëm

Kodi 4 shifror i RaiPay do të kërkohet për autentikimin e Pagesave me vlerë të madhe, rivendosjen e portofolit dhe për disa pagesa të bëra pas modalitetit PA (Autentikimit të zgjatur). Ky kodkalimi nuk ka nevojë të përputhet me PIN-in e kartave të debitit/kreditit.





- ② Përsëritni edhe një herë kodin e RaiPay, të krijuar rishtazi.

# Pjesa 2:

---

# Regjistrimi i një karte




## Instalimi

Ka dy mënyra për të shtuar një kartë debiti ose krediti në RaiPay.

- ① Kur shtoni kartën e parë, shfaqet një dialog i njoftimeve pas vendosjes së një fjalëkalimi (Fjalëkalimi i RaiPay). Shtypni butonin **SHTO NJË KARTË** për të filluar procesin e regjistrimit.

- ② Përndryshe, përdoruesi mund të shtypë jashtë dritares të njoftimeve të përmendur më lart dhe të shtypë butonin **Shto kartë të re** në pjesën e kartes.

Kjo është mënyra se si përdoruesi mund të regjistrojë edhe kartat shtesë.




## Vendosja e detajeve të kartave

Detajet e kartës kërkohen në një ekran të sigurt. Ekzistojnë tre mundësi si të futni detajet e kartës.

- ① Në mënyrë manuale duke shtypur një numër karte dhe datën e skadimit (dhe CVV2, e cila kërkohet për kartën Visa).
- ② Prekja në pjesën e pasme të telefonit të pajisur me NFC (me NFC të aktivizuar në cilësimet e telefonit).
- ③ Skanimi i detajeve të kartës me kamerën e telefonit.

Shtypni butonin **Shto kartë të re** për të përfunduar procesin.

Përdoruesit i kërkohet të mundësojë qasjen e kamerës në mënyrë që të vazhdojë me sukses.




## Verifikimi i detajeve të kartës


Pasi përdoruesi të shënojë detajet e kartës, një OTP (kod njëpërdorimesh ) i dërgohet numrit të telefonit të përdoruesit për verifikim me sms .

① Nëse numri i telefonit i shfaqur nga RaiPay është i saktë, përdoruesi duhet të shtypë **OK** për të marrë kodin OTP në një SMS.

Nëse numri i telefonit nuk është i saktë, përdoruesi duhet të shtypë **NUK ËSHTË NUMRI IM**.




② Nëse përdoruesi shtyp **NUK ËSHTË NUMRI IM**, një ekran njoftues që kërkon konfirmim nëse përdoruesi dëshiron të largohet nga procesi i verifikimit




③

Një ekran i ri tregon informacionin e kontaktit të qendrës së kontaktit. Përdoruesi duhet të telefonojë qendrën e kontaktit nëse nuk ka akses në numrin e telefonit të treguar më parë.





④

Nëse numri i treguar më parë ishte i saktë (në hapin 1), përdoruesit i kërkohet të verifikojë kartën e tij duke vendosur kodin njëpërdorimësh të ardhur me SMS.



⑤

Nëse shfaqet ky mesazh, karta nuk është verifikuar dhe ende nuk mund të përdoret në RaiPay. Përdoruesi duhet të shtypë VERIFY për të përfunduar procesin. Procesi i verifikimit rifillohet.



## Regjistrim i suksesshëm

- ① Emri i kartës
- ② Dizajni i kartës.
- ③ Etiketimi Default do të thotë që kjo kartë përdoret si një kartë e paracaktuar kur përdorni aplikacionin RaiPay për pagesa me NFC. Përdoruesi mund ta ndryshojë këtë, nëse ka më shumë se një kartë të regjistruar në RaiPay.
- ④ Rrethet e verdha tregojnë se karta është e gatshme për pagesa dhe teknologjia NFC është e aktivizuar.
- ⑤ Nëse përdoruesi ka më shumë se një kartë të regjistruar, ai mund të vendosë një kartë të ndryshme si të paracaktuar (kryesore) duke shtypur "Vendose si të paracaktuar".



# Pjesa 3:



# Pagesat

## Nivelet e autentikimit

Aplikacioni përdor **dy nivele të ndryshme autentikimi**.

Secili nivel përcaktohet nga dy parametra:

- Niveli 1 - Kërkoheç Ç'kyqja (Hapja nga çelësi) i Pajisjes
- Niveli 2- Kërkoheç fjalëkalimi/ Kodi i RaiPay

**Metoda e autorizimit të pagesës** - është e ndryshme në varësi të vlerës së saj:

a) Për transaksionet deri në 2,000 Lekë (përfshirë), pajisja celulare e kyçur vendoset afër terminalit POS, me ekranin e ndezur dhe është në gjendje të kryejë transaksione deri në një vlerë akumulative maksimale 12,000 ALL.

b) Për transaksione midis 2,000 Lekë dhe 10,000 Lekë (përfshirë), pajisja celulare e ç'kyçur duke përdorur metodën e percaktuar të ç'kyçjes së ekranit, vendoset afër terminalit POS;

c) Për transaksione që tejkalojnë 10,000 Lekë, pajisja celulare e kyçur me një fjalëkalim vendoset afër terminalit POS dhe kërkoheç vendosja e fjalëkalimit të Aplikacionit (fjalëkalimi i vendosur me instalimin e Aplikacionit).

d) Vlera Limitet maksimale për kryerjen e transaksioneve nëpërmjet pajisjes celulare dhe Aplikacionit RaiPay janë të njëjta me limitet e percaktuara të kartës tuaj.



e) Për sigurinë e transaksioneve të kryera përmes Aplikacionit dhe pavarësisht nga vlera e tij, përveç kërkesës për hyrjen e fjalëkalimit të Aplikacionit ose zhbllokimin e pajisjes celulare të përdorur për kryerjen e pagesave, përdoruesi gjithashtu ka mundësinë që të mundësojë funksionin "Siguri shtesë", dhe në këtë rast të gjitha transaksionet më të mëdha se 2,000 lekë autorizohen me fjalëkalimin e Aplikacionit

f) Për tërheqjen e parave në ATM, kërkoheç vendosja e PIN-it të kartës (dhe jo fjalëkalimin e aplikacionit) në terminalin e ATM-së (Aplikacioni mund të kryejë, përmes kartave të regjistruara, veprime të tërheqjes së parave në ATM që lejojnë përdorimin e Aplikacionit).

# Pjesa 4:

---

# Cilësimet




## Rruga për te Cilësimet (Settings)

Klikoni shenjën e rrotës për tu futur tek Cilësimet. Përdoruesi mund t'i përcaktojë preferencat, të ketë qasje tek informacioni lidhur me Qëndrën e Kontaktit për mbështetje, dhe gjithashtu të shohë informacione lidhur me Aplikacionin.

## Cilësimet e aplikacionit


Këtu përdoruesi mund:

- ① të gjejë butonin për të ndërruar temën (sfondin) e aplikacionit në ngjyrë të zezë.
- ② të heqë kartat nga aplikacioni.
- ③ të ndryshojë fjalëkalimin e RaiPay.
- ④ të caktojë RaiPay si aplikacionin e paracaktuar (kryesor) për pagesë (shih më poshtë).
- ⑤ të lexojë detajet e kontaktit
- ⑥ të lexojë Termat dhe Kushtet, si dhe versionin e aplikacionit RaiPay.




## Tema me ngjyrë të errët

Tema me ngjyrë të errët e ndërron ngjyrën e sfondit të aplikacionit në të errët.




## Cilësimet e fjalëkalimit

Përdoruesi mund ta ndryshojë fjalëkalimin e RaiPay duke klikuar tek **"Ndrysho PIN-in"**.




## Instalimi

- ① Përdoruesi fillimisht duhet të shkruajë fjalëkalimin aktual



- ② Fjalëkalimi i ri RaiPay duhet të shkruhet dy herë. Të dy herët duhet të shkruhet fjalëkalimi i njëjtë, përndryshe shfaqet një gabim në ekran, dhe përdoruesi duhet të fillojë edhe një herë procesin e ndryshimit të fjalëkalimit nga e para.



## Kalimi në siguri të shtuar


Përdoruesi mund të aktivizojë sigurinë e shtuar. Siguria e shtuar bën të mundur që të gjitha transaksionet më të mëdha se 2,000 lekë të autorizohen me fjalëkalimin e Aplikacionit.



Aktivizimi i sigurisë së shtuar duhet të konfirmohet me anë të fjalëkalimit të RaiPay (portofolit).

Pasi të aktivizohet siguria e shtuar të gjitha transaksionet më të mëdha se 2,000 lekë autorizohen me fjalëkalimin e Aplikacionit RaiPay.

Kjo veçori mund të ç'aktivizohet në çdo kohë.



## Heqja e kartës nga RaiPay

- 1 Klikoni ikonën e shportës për të hequr një kartë
- 2 Klikoni ikonën e shportës në fund, për t'i hequr të gjitha kartat nga portofoli.



Më pas shfaqet mesazhi njoftues (ekrani i njoftimeve) për të konfirmuar heqjen e kartës.



# Pjesa 5:

---

# Historiku i transaksioneve



## Shikoni historikun e transaksioneve

Për tu shfaqur historiku i transaksioneve të iniciuara nga Aplikacioni RaiPay, shtypni ikonën e transaksioneve (të rrethuar me ngjyrë të kuqe). Historiku i transaksioneve shfaq të gjitha transaksionet e iniciuara në RaiPay. Aty nuk shfaqen transaksionet të bëra me kartë plastike.



### Informacion i dobishëm

Transaksionet e refuzuara nga emetuesi nuk shfaqen këtu. Transaksionet e iniciuara me sukses në terminalin POS, por më vonë të anuluar apo të refuzuara nga emetuesi, etj, shfaqen këtu gjithashtu.



Përdoruesi mund të zgjedhë nga të gjithë kartat e regjistruara për të parë historikun e transaksioneve të iniciuara nga aplikacioni RaiPay.



Historiku i transaksioneve fillon me transaksionin më të fundit në krye.




Ikonat (të rrethuara me të kuqe) tregojnë se a ka qenë e nevojshme ndonjë metodë e autentifikimit si ç'kyçja e pajisjes ose fjalëkalimi i RaiPay për të kryer transaksionin. Ikona e çelësit nënkupton që përdoruesit i është dashur të përdorë ç'kyçjen e telefonit ose fjalëkalimin e RaiPay për të kryer transaksionin. Ikona e pagesës pa kontakt nënkupton që përdoruesi nuk ka pasur nevojë të përdorë metodat e autentifikimit.

# Pjesa 6:

---

## **Blokimi i kartës dhe portofolit ose ç'aktivizimi i NFC**




## Pezullimi i kartës (tokenit)

Karta(tokeni) në RaiPay mund të pezullohet vetëm nga qendra e kontaktit. Në rast se karta (tokeni) pezullohet në RaiPay:

- ① Mesazhi: **Karta është bllokuar** shfaqet mbi kartë
- ② Teknologjia NFC është çaktivizuar dhe karta nuk mund të përdoret në RaiPay. Rrathët do ndryshojnë ngjyrë nga e verdha në ngjyrë hiri.

### Informacion i dobishëm


Pezullimi i token-ëve nënkupton që karta e regjistruar në RaiPay nuk mund të përdoret për pagesa digjitale me anë të telefonit në RaiPay. Megjithatë, mbajtësi i kartës mund ta përdorë kartën plastike për transaksione apo pagesa.



## Bllokimi i RaiPay

RaiPay mund të bllokohet vetëm nga Qendra e Kontaktit. Kur RaiPay bllokohet, asnjë nga kartat e regjistruara nuk mund të përdoret.

Përdoruesit do t'i shfaqet ky njoftim kur ta hap aplikacionin RaiPay.



## Çaktivizimi i NFC

Kur ndodh çaktivizimi i NFC-së në cilësimet e pajisjes, përdoruesit nuk mund ta përdorin aplikacionin për pagesa.

Përdoruesi duhet të klikojë **Lejo** (Aktivizo) për tu drejtuar tek cilësimet e pajisjes dhe të aktivizojë NFC-në.

